# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443553**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | PD dënon kërcënimin ndaj Osman Stafës: Fjalën e lirë nuk mund ta mposhtë narkopolicia |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/pd-denon-kercenimin-ndaj-osman-stafes-fjalen-e-lire-nuk-mund-ta-mposhte-narkopolicia/1011118/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 15:05:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 15:03:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f8e171259c27cb63b0c87bfda5123b96ce9745736ed248b9b86766dabe04e6e8` |
| TEKSTI | `8ede928421dddcf27c9ec618a96d5490734ba37a6de52ed25027b5fa30aebad8` |
| PAMJA | `0d540c8d427a1319b81a8f93fcfe9bf13ec27827dd276025aef86b640fa47b90` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e1996e9b8d609a00550d5d72e7b4abd4dd76fe3d52d9ca927f282278c5dfc166` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e1996e9b8d609a00550d5d72e7b4abd4dd76fe3d52d9ca927f282278c5dfc166`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# PD dënon kërcënimin ndaj Osman Stafës: Fjalën e lirë nuk mund ta mposhtë narkopolicia



Partia Demokratike ka reaguar pas kërcënimit me vdekje ndaj gazetarit Osman Stafa, i cili publikoi pamje nga protesta e zhvilluar përpara Kuvendit.

Sipas PD-së, ngjarja nuk duhet parë si një incident i izoluar, por si pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj lirisë së shprehjes. Në reagim thuhet se një qeveri që përballet me denoncimet përmes presionit, intimidimit dhe frikësimit krijon një mjedis kërcënues për mediat.

Partia Demokratike kërkon që autori i kërcënimit të identifikohet dhe të përballet me drejtësinë, të hetohet lidhja e mundshme mes kërcënimit dhe pamjeve të publikuara, si dhe të bëhet identifikimi zyrtar i katër punonjësve të policisë. Gjithashtu, ajo kërkon sqarimin e urdhrave mbi të cilët efektivët kanë vepruar pa uniformë dhe garantimin e mbrojtjes për gazetarin Osman Stafa.

**DEKLARATA:**

Partia Demokratike e dënon ashpër kërcënimin me vdekje ndaj gazetarit të Neës24, Osman Stafa, pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit.

Personat me veshje civile që shfaqen në pamje gjatë ndalimit të një protestuesi janë katër punonjës policie. Ndërhyrja e efektivëve të Policisë së Shtetit pa uniforma dhe pa shenja identifikuese ndaj protestuesve paqësorë ngre dyshime serioze për veprime të paligjshme dhe për shmangie të përgjegjësisë.

Kërcënimi i bërë ndaj gazetarit pas publikimit të pamjeve nuk mund të konsiderohet një episod i zakonshëm. Hetimi duhet të nisë me urgjencë dhe të përcaktojë jo vetëm personin që ka dërguar mesazhin, por edhe nëse ai lidhet me ekspozimin e punonjësve të policisë dhe me punën profesionale të gazetarit.

Sipas PD-së, kjo ngjarje dëshmon për një klimë gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të nxitur nga një qeveri që denoncimet i pret me presion, intimidim dhe frikësim. Kur gazetarët kërcënohen për dokumentimin e

të fundit/


Pas 62 vitesh, "Seven Up!" mbyll rrugëtimin: protagonistët festojnë…


Tesla cakton prezantimin e Roadster-it pas nëntë…


Papa Leoni XIV anulon shkurtimin e pagave për kardinalët, rikthen…


Selanik, UEFA përcakton agjendën e vendimeve për finalet…


Kanadaja synon 1 trilion dollarë investime për të përballuar…


BE: Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë për…


Shtypja shtetërore në Rusi zgjerohet, qindra të mitur përballen me…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

sjelljes së policisë, synimi është heshtja e medias, fshehja e abuzimeve dhe mohimi i së drejtës së qytetarëve për të njohur të vërtetën.

Partia Demokratike kërkon:

Identifikimin dhe ndëshkimin ligjor të autorit të kërcënimit.

Hetimin e lidhjes së mundshme mes kërcënimit dhe pamjeve të publikuara.

Identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave që kanë shërbyer si bazë për veprimin e tyre pa uniformë.

Vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e mbrojtjes për gazetarin Osman Stafa.

PD shprehet se çdo heshtje apo vonesë e institucioneve do të përbënte mbrojtje politike për kërcënuesit dhe do t'u përcillte një mesazh frikësues gazetarëve që dokumentojnë abuzimet e pushtetit.

Partia Demokratike deklaron solidaritetin e saj të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.

Narkopolicia nuk do ta fitojë betejën me fjalën e lirë!

Shtuar më 14.09.2026 17:03

Tags: -Politikë , kryesorë , Lajmet e fundit , Shqiperia , Të Gjitha



Kërcënimi me jetë i gazetarit Osman Stafa, reagon Policia e Shtetit



AGSH ankimon rregulloren e GJKKO-së në Kushtetuese, Myzyraj dh…



Ilir Meta del nga kafazi/ Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidenti…



Kontroll "blic" në paraburgimin e Bradasheshit, në fokus…



Goditi me grusht qytetarin e shoqëruar gjatë protestës së sotme, pezullohet nga…



Klevis Balliu: Arben Ahmetaj është në rrezik, po kërkojnë ta rikthejnë në…



Operacioni "Anchor 3" në Durrës, sekuestrohen mbi 41 kilogramë kokainë në…




Tensione reale mes Ramës dhe Ballukut/ Berisha zbulon çfarë po ndodh në…

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.